

# A jeni ju një Punëtor Sezonal?



We speak your language 📞 13 1202

Are you a Seasonal Worker? — Albanian

## Çfarë është puna sezonale?

Punë sezonale është çdo lloj pune që kryhet vetëm për një pjesë (ose disa pjesë) të vitit, për çdo vit. Shumë punë në peshkim, bujqësi dhe turizëm janë sezonale.

Punët sezonale përfshijnë:

- Vjeljen e frutave
- Peshkimin
- Të korrat/mbledhjen e prodhimeve bujqësore
- Qethjen e dheneve
- Punën në një industri që varet nga ndalimet e plota të punës.

Nëse ju do të bëni kërkesë për:

- Newstart Allowance (Pagesë për personat që janë në kërkim të punës)
- Youth Allowance (Pagesë për Moshat e Reja) (jo për studentat me shkëputje nga puna)
- Parenting Payment (Partnered) (Pagesë për Prindin) (kur prindërit jetojnë së bashku)
- Widow Allowance (Pagesë për personat e Ve)

## DHE

në gjashtë muajt përpara së të bëni kërkesën ju (ose partneri juaj) keni mbaruar një punë sezonale, ju mund t'ju duhet të prisni për pagesën për arsye të parave që keni marrë gjatë kohës që keni punuar. Kjo quhet Seasonal Work Preclusion Period (Periudha e Përrjashtimit të Punës Sezonale).

Për më shumë informacion në Shqip, telefononi **13 1202\*** ose vizitoni adresën tonë të internetit **[www.centrelink.gov.au](http://www.centrelink.gov.au)**

\*Thirrjet me numrat që fillojnë me "13" nga një shërbim standard telefonik mund të bëhen prej kudo në Australi për jo më shumë se kostoja e një thirrje lokale (çmimi për thirrje mund të ndryshojë në varësi kompanisë së telefonit që ju siguron shërbimin telefonik). Thirrjet me numrat "1800" janë falas. Çmimet për thirrjet nga telefonat publikë dhe celularët mund të jenë më të larta.

## Çfarë do të thotë kjo për ju?

Nëse puna që ju keni bërë i përmbahet këtij përshkrimi, dhe pagat e paguara janë të larta, do të llogaritet periudha e përjashtimit të punës sezonale për të vendosur se sa kohë ju duhet të prisni përpara se të paguheni. Nëse puna që keni bërë ka zgjatur më shumë se një vit, ose ju keni akumuluar pushime gjatë kohës që keni punuar, ju nuk ndikoheni. Nëse nuk jeni të sigurtë nëse ju ndikoheni, bisedoni me Centrelink.

## Sa zgjatë periudha e përjashtimit?

Nëse të ardhurat tuaja kanë qënë mbi Average Weekly Ordinary Time Earnings (Paga Mesatare Javore për Kohën Normale të Punës) — \$948 për një javë për një person dhe \$1896 në javë për çift, në Shkurt të 2004, atëherë ju mund t'ju duhet të prisni disa kohë përpara se të keni të drejtë të paguheni. Kontaktoni Centrelink për shifrat aktuale.

[www.centrelink.gov.au](http://www.centrelink.gov.au)



Australian Government



MCLW009.0512ALB (page 1 of 1)